



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1063/4 Prot.

Vlorë, më 18.08.2017

Vendim
Nr. 26, datë 18.08.2017

PËR ÇELJEN E SHTËPISË BOTUESE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË ME AKRONIMIN UNIVLORAPRESS

Bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës e 18.08.2017


VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për çeljen e shtëpisë botuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me akronimin "UNIVLORAPRESS".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Bashkangjitur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës me nr. 1064/1 Prot, datë 18.08.2017 së bashku me relacionin përkatës.

1. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar
6. Marinela Muço - anëtar

OLSI VANGJELI

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTOR

Nr. 1066/11 Prot.

Vlorë, më 18.08.2017

Lënda: Kërkesë për miratim dhe Relacion shpjegues/argumentues për çeljen e shtëpisë botuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, me akronimin UNIVLORAPRESS.

Drejtuar: Bordit të Administrimit


E nderuara znj. Kryetare,

Të nderuar anëtarë,

Bazuar në Strukturën dhe organigramën e UV-së, miratuar me vendimin e Senatit nr. 10, datë 27.01.2017 në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit (miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr. 78, datë 18.07.2017), në vizionin e promovimit brenda vendit dhe ndërkombëtarizimin e institucionit në mbarë botën si dhe në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe të të ardhurave parashikuar nga neni 108 "Për Autonominë Financiare të Institucioneve të Arsimit të Lartë", i Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, kërkojmë nga ana Juaj miratimin e kërkesës sonë (Senatit dhe Rektorit) për krijimin e Shtëpisë Botuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, me akronimin UNIVLORAPRESS

Kjo iniciativë e cila besojmë se është e para në rastin e IAL-ve publike në Shqipëri, është një procedurë normale për institucionet e Arsimit të Lartë në gjithë botën.

Në linkun e mëposhtëm keni të gjitha universitetet në botë të cilat kanë shtëpi botuese (https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_university_presses). Aty shihet qartë se Universitetet Evropiane e botërore të njohura si Oxford, Yale, Cambridge, Colorado, Edinburg etj., kanë struktura të tilla nëpërmjet të cilave kryejnë një gamë të gjerë shërbimesh për veten dhe për të tretët.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

Kjo iniciativë nuk do jetë vetëm një hap i rëndësishëm i Universitetit të Vlorës për të ardhur më afër Universiteteve Evropiane dhe botërore por do të jetë dhe një mundësi më shumë për të përmirësuar të ardhurat e tij.


Qëllimi kryesor i shtëpisë botuese do të jetë promovimi i librave të shkencës dhe librave akademikë. Shtëpia botuese e UV-së me akronimin UNIVLORAPRESS do botojë vepra në formatin klasik dhe atë elektronik. Punimet që do të botohen do të jenë në fusha të ndryshme, dhe autorët do të jenë pedagogët e universiteti, por edhe akademikë nga vendi dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, shtëpia botuese do ketë mundësinë të botoj libra, broshura, fletëpalosje dhe materiale të tjera si nga sektori shtetëror ashtu dhe nga ai privat. Të gjitha këto i japin rëndësi akoma më të madhe kësaj iniciative sepse një numër i madh i librave (edhe/ose publikimeve) nuk do u drejtohen vetëm studentëve dhe pedagogëve por do të synojnë publikun e gjerë, duke qenë libra/publikime me interes të përgjithshëm.

Përveç librave shtëpia botuese do publikojë revista shkencore, fletpalosje, broshura (nga sektori shtetëror dhe nga ai privat) dhe më gjerë të cilat do të jenë një e ardhur akoma më shumë për Institucionin.

Disa nga avantazhet dhe përfitimet që Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorë do ketë nga krijimi i Shtëpisë Botuese do të jenë:

1. Botimi i revistave shkencore dhe librave që promovojnë rezultatet e kërkimit shkencor në fusha të ndryshme shkencore;
2. Mbështetja e studentëve në mënyrë që të kenë qasje në botime cilësore shkencore;
3. Mbështetja e pedagogëve, mësuesve, studentëve dhe kërkuesve për të publikuar rezultatet e tyre shkencore;
4. Shpërndarja e rezultateve të konferencave shkencore, takimeve dhe seminareve mbi temat bashkohore;
5. Përfitimi i të ardhurave nga botimet e librave, revistave etj;
6. Përfitimi i të ardhurave nga botime broshurave, fletpalosjeve etj nga të tretë të cilëve Universiteti do u ofroj shërbime të tilla;
7. Ulja e kostos afatgjate për Universitetin nga botimi dhe printimi i broshurave dhe fletpalosjeve etj. të cilat tashti ja ofrojnë të tretët;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

8. Buxhetet e Bibliotekës aktuale nuk mund të ruajnë ritmin me kërkesën për kopje të shtypura të shumë teksteve popullore. Kjo qasje (shtëpia botuese) mund të ndihmojë në reduktimin e presioneve buxhetore;
9. Studentët do të kenë akses më të shpejt në libra/publikime me një kosto shumë më të ulët;
10. Pjesëmarrja në panairë kombëtare e ndërkombëtare të librit shqip dhe në gjuhë të huaj.
11. Promovimin e personaliteteve të shquara botërore në të gjitha fushat, sidomos ata të sferës akademike, (përmes përkthimit dhe botimit nga Univlorapress) me qëllimin e dyfishtë: promovimin e tyre dhe të UV- së njëherazi.

Shënim: Kërkesa në fjalë nënkupton miratim të UNIVLORAPRESS vetëm si logo botuese përfaqësuese, pra si Ent apo studio Publikimi, por jo si ent realizues Shtypshkronjë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Prof. Dr. Roland ZISI
REKTOR

Ky dokument përpilohet ne 3 (tre) kopje.